



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3812 Prot.

Roskovec, më 30/07/2020

VENDIM


NR 61 .DATË 28.07.2020

**“PËR
DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT PËR T’U PËRDORUR PËR QËLLIME,
KULTURORE, ARSIMORE DHE SPORTIVE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 gërma a) dhe gërma c e tij si dhe neni 54, gërma e; Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, nenet 801 dhe në vazhdim; VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu 1, pika 2, pika 6, gërma b dhe Kreu II pika 1; Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 13, datë 26.4.2018 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, pika 3, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Dhënie me qira të truallit të ndodhur në Bllokun nr. 2 qendra e qytetit Roskovec për t’u përdorur për qëllime kulturore, arsimore dhe sportive.
2. Miratohet që të jepet me qira truall me sipërfaqe 380 m², në pronësi të Bashkisë Roskovec, me nr. Pasurie 2/172; 2/356 dhe 2/331, zona kadastrale 3196, sipas kartelave të pasurisë. Këto pasuri janë pronë e bashkisë Roskovec përfituar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 16.01.2019 “Për shpronësimin për interes publik të pasurive që do të preken nga zbatimi i projektit “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimor, Blloku nr. 2, Qendra e qytetit Roskovec”.
3. Afati i dhënies me qira të truallit do të jetë 1 (një) vit me të drejtë përsëritje.
4. Procedura për dhënie me qira sipas VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” do të fillojë pasi të jenë marrë miratimet nga institucionet përkatëse.



5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit, dhe Drejtoria Juridike me vijimin e procedurave të dhënies me qira.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

